

Tiranë, më 5 Gusht 2021

KËRKESË PËR OFERTË

SUBJEKT TREGTAR I CILI OFRON ME QERA NJË SALLE BASHKË ME PAJISJET MBËSHETËSE, PËR REALIZIMIN E NJË TRYEZE TË RRUMBULLAKËT KONSULTIMI


Hyrje

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) në bashkëpunim me Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në kuadër të implementimit të grantit të akorduar në zbatim të projektit “Për mbështetjen e Kuvendit dhe Edukimit Qytetar (PACEP)”, projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e zbatuar nga Prezenca e OSBE në Shqipëri dhe Instituti Demokratik Amerikan (NDI), shpall kërkesën për ofertë për një subjekt tregtar i cili ofron me qera, për një ditë, një salle konferencash bashkë me pajisjet mbështetëse (mikrofonë statikë dhe 2 të lëvizshëm/sistem audio/monitor vizual për shfaqjen e ppt, internet Wifi, pajisjet për përkthim simultan) për organizimin e një tryeze të rrumbullakët konsultimi si dhe ofrimin e drekës për të ftuarit. Kjo tryezë konsultimi do të organizohet më datë 13.09.2021, me pjesëmarrje fizike të 40 personave^{1*}

KShH fton të gjitha subjektet e interesuara që të dërgojnë në formë elektronike në adresën e e-mailit të KShH-së office@ahc.org.al ose postare, deri në datën 06.08.2021, ora 10:00 dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Ofertën financiare për sallë për zhvillimin e tryezës së përbashkët të konsultimit për një ditë bashkë me pajisjet mbështetëse (mikrofonë statikë dhe 2 të lëvizshëm/sistem audio/monitor vizual për shfaqjen e ppt, internet Wifi, pajisjet për përkthim simultan)
2. Ofertën financiare në formën kosto për person për konsumimin e drekës (bashkëngjitur ofertës edhe menunë).
3. Ofertën financiare në Dollarë (TVSH e përfshirë)
4. Oferta duhet të jetë e firmosur dhe e vulosur

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:



**Nisur nga gjendja e përhapjes së pandemisë globale Covid-19 dhe masave të marra nga ana e Qeverisë Shqiptare, kjo tryezë e rrumbullakët mund të pësojë ndryshime në formatin e realizimit të saj. Subjekti i përzgjedhur do të njoftohet paraprakisht nga ana e KShH-së mbi çdo ndryshim eventual që mund të shkaktohet nga kushte dhe rrethana të pamundura për t'u menaxhuar nga ana e KShH-së.*